



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 74

Tiranë – E hënë, 10 prill 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 2, datë 9.2.2017	Për miratimin e Programit Operacional për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve 2017-2018..... 4671
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 14, datë 21.3.2017	Për miratimin e financimit për grantin “Nënprogrami i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)”, të programit “Mbështetje për ekonominë”, si dhe të kalendarit me datën e fillimit të aplikimeve, për vitin 2017..... 4691



VENDIM
Nr. 2, datë 9.2.2017

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT
OPERACIONAL PËR FONDIN E
ZHVILLIMIT TË RAJONEVE 2017-2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3 të ligjit nr.130, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e Programit Operacional për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, 2017-2018, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Shëndetësisë, ministri i Kulturës, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Mjedisit, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



PROGRAMI OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN RAJONAL 2017–2018

I. HYRJE

Programi Operacional për Zhvillimin Rajonal është dokumenti kuadër që paraqet drejtimit kryesorë të ndërhyrjes së Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (F.ZH.R.) për periudhën 2017–2018, si edhe orientimet parimore të shpërndarjes së fondeve të F.ZH.R.

Dokumenti është hartuar në përputhje me detyrimet në kuadër të ligjit nr.130/2016, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, aneksi 3, ku përcaktohen rregullat e funksionimit të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (F.ZH.R.).

II. KUADRI STRATEGJIK I POLITIKËS SË ZHVILLIMIT RAJONAL

1. Sfidat e zhvillimit të politikës

Sot ekziston nevoja për të zhvilluar një platformë koherente për zhvillimin lokal dhe rajonal, me qasjen territoriale, veç asaj sektoriale. Politikat e zhvillimit rajonal e kohezionit dhe instrumentat e lidhur me to janë pasqyrimi më i drejtpërdrejtë i qasjes territoriale, me qëllim sjelljen e perspektivës territoriale (horizontale), përmes koordinimit me instrumentat sektorial (vertikale) dhe vendim-marrës. Arsyeja pas kësaj qasjeje i ka rrënjët në nevojën për ndërhyrje të integruara për zhvillimin e territoreve dhe fuqizimin e potencialeve social-ekonomike të rajoneve, inkurajimin e modeleve të qëndrueshme të bashkëpunimit dhe partneriteteve për zhvillimin, reduktimin e diferencave socio-ekonomike midis rajoneve/territoreve dhe promovimin e fuqizimin e ekonomive lokale, rajonale e ndër-rajonale.

Qasja në “grante” ka orientim sektorial, duke nxitur kështu nevojën e financimit përmes programeve zhvillimore me dimension hapësinor/territorial, me fokus zhvillimin e rajoneve të zhvillimit¹, përmes ndërhyrjeve të integruara dhe prerjes midis sektorëve, në *objektiva kryesorë dhe drejtime prioritare*.

Nevoja për një kuadër zhvillimor të integruar të territorit është paraqitur edhe në Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Republikës së Shqipërisë², që përbën kuadrin e politikës së zhvillimit territorial, me fokus edhe kohezionin territorial. Aty trajtohet koncepti i korridoreve strategjike, poleve të zhvillimit rajonal, konceptin e rajoneve të zhvillimit, si përpjekje për përafrimin me politikën që nxit dhe mbështet edhe Fondi Evropian për Zhvillimin e Rajoneve, si edhe me vendimin nr.961, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të agjencive të zhvillimit rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”.

Ndërkohë po punohet për të hartuar një politikë (komplekse) kombëtare të zhvillimit rajonal, si edhe plotësuar kuadrin përkatës ligjor, të lidhura me të, gjithashtu për të bërë përmirësime të tjera për zbatimin e politikës (përmes reformës për zhvillimin rajonal), sidomos nën

¹ Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.961, datë 2.12.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të agjencive të zhvillimit rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”

² Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr.881, datë 14.12.2016.



perspektivën e integritimit në BE dhe përafrimit me politikën e kohezionit të BE-së dhe fondeve strukturore (Kapitulli 22).

2. Konteksti i politikës rajonale të BE-së për zhvillimin rajonal

Në Evropë qasja ndaj zhvillimit rajonal ka përparuar dhe është transformuar nga një politikë shtetërore mbështetëse të zhvillimit, në një politikë që synon nxitjen e rajoneve (territoreve) për të gjeneruar zhvillim, duke vënë në përdorim burimet e tyre dhe duke konkurruar midis tyre. Po ashtu, edhe dimensionin territorial po fiton gjithnjë e më shumë hapësirë në formulimin dhe zbatimin e politikave evropiane.

Fondi Evropian i Zhvillimit të Rajoneve (FEZHR) për periudhën 2014–2020 i fokuson investimet në disa akse prioritare, të njohura si “përqendrime tematike”, përkatësisht:

- inovacioni dhe hulumtimi;
- axhenda dixhitale;
- mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME);
- ekonomia e ulët të karbonit.

FEZHR-ja, gjithashtu, i kushton vëmendje të veçantë karakteristikave specifike territoriale. Masat e FEZHR-së janë projektuar për të reduktuar problemet ekonomike, mjedisore dhe sociale në zonat urbane me fokus të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm urban.

Të paktën 5% e burimeve të FEZHR-së janë të vendosura përmes “veprimeve të integruara”, të menaxhuara nga qytetet.

Zonat e disavantazuara nga një këndvështrim gjeografik (zonat e largëta malore ose zonat me popullsi të ulët) përfitojnë nga trajtimi i veçantë. Së fundi, zonat larg qendrës gjithashtu përfitojnë nga ndihma specifike e FEZHR-së, për të trajtuar disavantazhet e mundshme për shkak të largësisë së tyre.

3. Kuadri ligjor për zhvillimin rajonal

Ligji vjetor i buxhetit³ përbën bazën kryesore ligjore të lidhur me funksionimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (F.ZH.R.), si instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues, që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe lokal. Sipas tij, qëllimi i F.ZH.R. është sigurimi i zbatimit të objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të patur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor. F.ZH.R. përbëhet e financohet nga 6 programe buxhetore, të disa ministrive.

Aneksi 3 i ligjit përcakton 3 Programet kryesore, pjesë e F.ZH.R., të cilat mbështesin dhe financojnë politikën e zhvillimit rajonal dhe kohezionit territorial: (i) Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, (ii) Programi për Mbështetjen për Ekonominë, (iii) Programi Shqipëria Dixhitale, të cilat mbështesin projektet me ndikim në zhvillimin rajonal dhe lokal që:

- a) Nxisin zhvillimin rajonal dhe lokal dhe ndikojnë në arritjen e objektivave të zhvillimit, kohezionit territorial dhe rritjes së konkurrencës së rajoneve tona;
- b) Mbështesin krijimin dhe funksionimin e partneriteteve ndërvendore dhe rajonale midis vetë njësive të qeverisjes vendore, dhe agjentëve të tjerë të zhvillimit;

³ Ligji nr.130/2016, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”.



- c) Nxisin dhe mbështesin krijimin e partneriteteve, në nivelin rajonal dhe vendor, me natyrë ekonomike publike dhe private, në forma organizimi tregëtar, me qëllim shtimin e burimeve të investueshme, sidomos në ata sektorë që kanë prioritet për zhvillimin lokal dhe rajonal, dhe qëndrueshmërinë e investimeve dhe projekteve përmes përbalueshmërisë financiare dhe kthimit;
- d) ofrojnë asistencë, agjentëve zhvillimorë të interesuar për të hartuar e zbatuar projekte që mbështesin arritjen e objektivave të zhvillimit.

Aneksi 3 i ligjit përcakton përgjegjësitë dhe role kryesore të mekanizmit për funksionimin e F.ZH.R., ku struktura vendimmarrëse është përcaktuar Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (K.ZH.R.).

Një akt i rëndësishëm ligjor është edhe Vendimi nr.961 i Këshillit të Ministrave, datë 2.12.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të agjencive të zhvillimit rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”.

Vendimi përcakton krijimin, funksionimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (A.K.ZH.R.), katër agjencive të zhvillimit rajonal (A.ZH.R.) dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal (A.ZH.E.R.). Këto struktura kanë misionin e promovimit të një politike të përbashkët investimesh, të integruara, për zhvillimin e rajoneve dhe potencialeve të tyre, inkurajimin e një modeli sa më të gjërë bashkëpunimi, krijimin e partneriteteve publik-privat me interes të përbashkët zhvillimi, ngritjen e rrjetëzimeve rajonale dhe ndër-rajonale, zvogëlimin e dallimit hendekut mes ndërmjet zonave të zhvilluara dhe të pazhvilluara. si dhe projekte publike e private.

Vendimi miraton katër rajone zhvillimi, të cilat nuk janë zona administrative-territoriale, por janë zona/territore të lidhura me programimin dhe zbatimin e një politike të integruar zhvillimi rajonal dhe kohezioni territorial. Këto rajone janë si vijon:

- **Rajoni i zhvillimit 1** - përfshin qarqet Shkodër, Lezhë dhe Kukës
- **Rajoni i zhvillimit 2** - përfshin qarqet Tiranë, Durrës dhe Dibër
- **Rajoni i zhvillimit 3** - përfshin qarqet Elbasan, Korçë dhe Berat.
- **Rajoni i zhvillimit 4** - që përfshin qarqet Fier, Vlorë dhe Gjikastër

Në kuadër të reformës së zhvillimit rajonal, të ndërmarrë nga qeveria shqiptare, me asistencën e partnerëve ndërkombëtarë, është punuar për zhvillimin e mëtejshëm të politikës kombëtare për zhvillimin rajonal. Gjatë vitit 2016 u hartua një dokument kuadër politikash, i cili mbështeti përgatitjen e një projektligji për zhvillimin rajonal. Ky projekakt u konsultua me institucionet qendrore e vendore dhe pritet të progresojë gjatë vitit 2017, me diskutime në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvend. Miratimi i këtij projekt-ligji krijon mundësinë e plotësimit të mëtejshëm me aktet nënligjore, si dhe hartimin e Programit Operacional për Zhvillimin Rajonal, si një dokument programor afatmesëm.

4. Kuadri strategjik për zhvillimin rajonal – Kuadri i politikës

Dokumentet kryesore strategjike të kuadrit strategjik për zhvillimin rajonal, janë (por pa u kufizuar): Programi i Qeverisë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (S.K.ZH.I.) 2015-2020, si edhe disa strategji sektoriale/ndërsektoriale, Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Plani i Integruar i Bregdetit Tiranë – Durrës etj.



Programi i qeverisë përcakton si prioritet të politikës për rajonalizimin (ndarjen e vendit në rajone) edhe reformën rajonale. Programi lidhet me:

- i) krijimin e rajoneve dhe rikonfigurimin e qarqeve sipas modeleve evropiane të rajoneve dhe vetëqeverisjes;
- ii) udhëheqjen e re lidhur me politikën zhvillimore kombëtare dhe rajonale;
- iii) rritjen e funksioneve dhe kompetencave të njësive ekonomike të qeverisë shqiptare në nivel rajonal;
- iv) rritjen e burimeve financiare dhe aseteve në rajonet respektive;
- v) modelin e ri dhe më efikas për autoritetet qendrore dhe lokale në nivel rajonal;
- vi) reformën vendimtare për përfshirjen e Shqipërisë si një vend kandidat i BE-së;
- vii) mbështetjen teknike dhe fondet nga instrumentet e BE-së për fuqizimin e rajoneve.

Një dokument me rëndësi për politikën e zhvillimit rajonal dhe kohezionit territorial është edhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (S.K.ZH.I.) 2015-2020, miratuar me VKM nr.348, datë 11.5.2016. Ky është dokumenti themelor për orientimin e politikave kombëtare, me qëllim arritjen e standardeve të nevojshme për integrimin e vendit në BE, të kombinuar me axhendën zhvillimore dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

SKZHI identifikon si sfidat kryesore për t'u adresuar gjatë viteve 2015-2020, si më poshtë:

- nevoja për adresimin e zhvillimit të pabarabartë midis rajoneve brenda vendit dhe në kontekstin ndërkombëtar;
- balancimi i zhvillimit midis rajoneve dhe brenda bashkive, midis zonave urbane e atyre rurale, si dhe midis zonave bregdetare e atyre periferike malore;
- trajtimi i aspekteve që lidhen me migrimin dhe emigrimin (brenda e jashtë vendit);
- trajtimi i aspekteve që lidhen me mbipopullimin në zonat më të zhvilluara dhe largimin nga zona të tjera;
- nevoja për trajtimin e dobësive në kuadrin e politikave dhe kapaciteteve institucionale.

SKZHI-ja përcakton vizionin për politikën e zhvillimit rajonal, të bazuar në zhvillimin e balancuar, duke rritur kështu konkurrueshmërinë e vendit. Gjithashtu, SKZHI paraqet objektivat strategjikë afatgjatë të politikës së zhvillimit rajonal, si vijon:

1. Nxitja e konkurrueshmërisë mes rajoneve, përmes nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik të komuniteteve të tyre, duke ofruar mbështetje për:

- sigurimin e zhvillimit ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe ofrimin e arsimit profesional, duke iu përgjigjur nevojave të tregut të punës;
- përmirësimin e infrastrukturës lidhëse ndërmjet dhe brenda rajoneve;
- zgjerimin e funksioneve të zonave dhe diversifikim të ekonomive rurale;
- nxitjen e përdorimit të burimeve unike social-ekonomike e kulturore të rajoneve.

2. Rritje e kohezionit rajonal, nëpërmjet uljes së pabarazive ekzistuese në shfrytëzimin e burimeve, produktivitetin dhe standardet sociale/mjedisore, nëpërmjet:

- përmirësimin e standardeve të infrastrukturës publike dhe rrjeteve të shërbimeve;
- sigurimit të mbrojtjes rajonale të integruar të mjedisit;
- sigurimit të rritjes së investimeve publike në rajonet më pak të zhvilluara.

3. Menaxhim efektiv i zhvillimit rajonal, nëpërmjet një nxitjeje të re e pragmatike për zhvillimin rajonal, duke përdorur me efikasitet burimet e kufizuara menaxheriale, nëpërmjet:

- ndërtimit të kapaciteteve për zhvillimin rajonal në të gjitha nivelet e qeverisjes;
- krijimit të mekanizmave efikasë dhe eficientë për menaxhimin e zhvillimit rajonal;



- përmirësimit të bashkëpunimit ndërsektorial dhe aplikimit të qasjes territoriale të zhvillimit;
- përmirësimit të koordinimit në procesin e hartimit të strategjive përmes përfshirjes së aktorëve rajonalë, për të garantuar që strategjitë sektoriale (koordinimi vertikal) marrin në konsideratë specifikat rajonale, si dhe strategjive e programeve rajonale, që integrojnë objektivat e strategjive sektoriale;
- krijimit të një sistemi monitorimi të kombinuar me zbatimin e strategjive rajonale në nivel rajonal, sipas standarde të njëjta, vendosura nga qeverisja qendrore.

SKZHI paraqet një nxitje gjithëpërfshirëse për decentralizimin dhe forcimin e qeverisjes vendore, në përputhje me parimet e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore dhe me parimet mbi qeverisjen vendore, të sanksionuara në dokumentet administrative evropiane, me qëllim sigurimin politik, decentralizimin administrativë e fiskal.

Pjesë e kuadrit të politikës ku mbështetet Programi Operacional për Zhvillimin Rajonal është edhe Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Republikës së Shqipërisë⁴, strategjitë sektoriale e ndërsektoriale, si edhe deklaratat e politikave të programeve buxhetore, që financojnë Fondin për Zhvillimin e Rajoneve.

Veç të tjerave, ky program mbështetet edhe në Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 (SKNDQV), ku paraqitet vizioni i qeverisë shqiptare për forcimin e demokracisë vendore dhe përparimin e procesit të decentralizimit sipas standardeve më të përparuara evropiane, orientuar edhe nga Politika e Kohezionit e BE-së.

Politika jonë e Zhvillimit Rajonal dhe veprimet reformuese orientohen edhe nga politika e kohezionit e BE-së, në rrugën e Shqipërisë drejtë integritit, përmes harmonizimit dhe përafrimit.

5. Mekanizmat institucionalë dhe instrumentet financiare për zhvillimin e rajoneve

Në bazë të aneksit 3, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, instrumenti i financimit, i cili adreson praktikisht disa aspekte dhe çështje të zhvillimit rajonal, është Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përfaqëson një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal e vendor, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të pasur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga 3 programe financimi:

1. “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale”, i cili përbëhet nga 6 grante konkurruese (infrastruktura vendore dhe rajonale, arsimi, shëndetësia, artikulura, ujësjellës-kanalizimet, rehabilitimi mjedisor, gjelbërimi dhe pyllëzimi).
2. Programi “Shqipëria dixhitale” përbëhet nga granti për Shqipërinë dixhitale.
3. “Programi i mbështetjes për ekonominë” përbëhet nga dy grante.

Ministritë përkatëse, sipas granteve konkurruese, parashikojnë në programet e tyre buxhetore, vjetore dhe 3-vjeçare, një përqindje të caktuar buxheti, për formimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

Grantet konkurruese më domethënëse nga pikëpamja e financimit janë:

⁴ Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr.881, datë 14.12.2016.



1. granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale.
2. grantet për arsimin;
3. granti për shëndetësinë;
4. granti për artin dhe kulturën;
5. granti për ujësjellës-kanalizime;
6. granti konkurrues për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim.

Në ndryshim nga grantet e tjera, granti “Shqipëria dixhitale” dhe grantet e “Programit të mbështetjes për ekonominë” e kanë burimin e financimit nga Programi buxhetor “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban

5.1 Fondi për Zhvillimin e Rajoneve – retrospektiva dhe perspektiva

Për vitin 2014, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve u orientua për financimin e projekteve të reja në përgjigje të nevojave të njësive të qeverisjes vendore dhe orientimit të ri të politikës dhe objektivave, por edhe financimin e detyrimeve të prapambetura për projektet në vazhdim, të periudhës 2012-2013.

Për vitin 2015, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve ka financuar projekte të reja, në funksion të programit me objektiv kryesor rilindjen urbane, përmes zhvillimit të bashkjetesës qytetare, orientuar në rehabilitimin e shesheve, bulevardëve, pedonaleve, pazareve, ballinave ujore dhe hapësirave publike, rrotull kalave apo objekteve me interes turistik, të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe projektet në vazhdim nga viti i mëparshëm.

Për vitin 2016, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve u orientua për financimin e projekteve të reja, që mbështesin ndërhyrjet e nisura dhe fuqizimin e impaktit të tyre, si dhe filloi të përvijohet si drejtim edhe fuqizimi dhe stimulimi i ekonomive lokale.

Për vitin 2017, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve synon rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të politikave, duke kontribuar në forcimin e qyteteve/fshatrave dhe komuniteteve por edhe në fuqizimin e mundësive për ekonomi lokale dhe rajonale, si edhe promovimin e rajoneve konkurruese me një zhvillim të qëndrueshëm social, ekonomik dhe mjedisor, në zbatim të politikës së kohezionit territorial.

Sipas aneksit 3, të ligjit “Për buxhetin për vitin 2017”, shtyllat kryesore të investimeve të F.ZH.R konsistojnë në:

- Zhvillimin e infrastrukturës lokale, rajonale dhe urbane;
- Mbështetjen për ekonominë;
- Shqipëria dixhitale.

III. SFIDAT DHE POTENCIALET

1. SFIDAT

Në zhvillimet e ndodhura gjatë vitit 2016 u hodhën hapa konkretë në strukturimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve dhe analizën për përgatitjen e dokumenteve të reja të politikës së zhvillimit rajonal (për tre vitet në vijim), përgatitjen e projektligjit për zhvillimin rajonal dhe kohezionin, konceptin e katër rajoneve të zhvillimit të vëndit, si dhe ngritjen e katër agjencive të zhvillimit rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal.

Sfida kryesore në procesin e rajonalizimit është nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal, rritja e kohezionit nëpërmjet uljes së pabarazive ekzistuese në shfrytëzimin e burimeve, produktivitetin dhe standardet sociale/mjedisore, nëpërmjet menaxhimit efektiv të zhvillimit rajonal, përmes ngritjes së një sistemi të menaxhimit rajonal me parimin e qeverisjes në shumë nivele.



Sfidë tjetër e rëndësishme është edhe aktivizimi i potencialeve, përmes një qasjeje metabolike, për të nxitur krijimin e vlerës për ekonomi rajonale dhe që rritja të financojë kështu uljen e pabarazisë së zhvillimit me vend të vetëm ndërhyrjeve ekualizuese dhe mbështetëse.

1.1 Demografia dhe potencialet territoriale

Sipas të dhënave, ndryshimet demografike në Shqipëri do të sjellin ndryshime të konsiderueshme në dekadën e ardhshme. Sipas parashikimeve të popullsisë së Shqipërisë (2011-2031), ajo do të përjetojë një rënie të numrit të lindjeve dhe rritja e saj natyrore do të jetë e barabartë me zero, d.m.th. lindjet do të jenë të barabarta me numrin e vdekjeve, në 2027.

Rajoni i zhvillimit 1 - përfshin qarqet Shkodër, Lezhë dhe Kukës. Ky rajon ka potenciale në zhvillimin e turizmit malor duke u përfaqësuar me pasuri të rralla natyrore si: Parku Kombëtar i Luginës së Valbonës si dhe intenerarin turistik të alpeve. Infstruktura kryesore lidhëse e ngritur dhe daljet në Malin e Zi dhe Kosovë stimulojnë zhvillimin e turizmit ndërkufitar. Ky territor është gjithashtu i pasur me burime natyrore dhe prodhime të veçanta bujqësore.

Popullsinë më të madhe në këtë rajon e ka qarku i Shkodrës me 215.483 banorë në 2016, me një dendësi 64 banorë për km². Qarku i Lezhës ka dendësinë më të lartë në rajon, me 83 banorë për km² dhe me një popullësi totale prej 135.613 banorësh. Ndërsa qarku i Kukësit ka dendësinë më të ulët në nivel kombëtar, me 35 banorë për km² dhe me një popullësi prej 84.035 banorësh për vitin 2016.

Rajoni i zhvillimit 2 - përfshin qarqet Tiranë, Durrës dhe Dibrë. Ky rajon ka potenciale të zhvillimit ekonomik, si qendra e shërbimeve kryesore, dhe vendndodhja e aeroportit kombëtar. Ky rajon përveç daljes në detin Adriatik me anë të portit kryesor kombëtar ka dalje tokësore gjithashtu me Maqedoninë.

Fasha ekonomike e Duranës përbën një potencial zhvillimi jo vetëm për rajonin, por në nivel kombëtar. Territori përshkohet nga Rruga e Arbrit dhe pjesë e vlerave historike me rëndësi kombëtare është dhe intenerari historik i Skënderbeut.

Qarku i Tiranës, për vitin 2016, numëron popullsinë më të madhe jo vetëm në nivel rajoni, por edhe në nivel kombëtar, me 811.649 banorë dhe gjithashtu me dendësinë më lartë prej 489 banorësh për km². Qarku i Durrësit ka një popullsi prej 278.775 banorësh, me një dendësi që arrin 363 banorë për km². Ndërsa qarku i Dibrës me 55 banorë për km² (ndër dendësitë më të ulta në nivel kombëtar) ka një popullësi totale për 2016, me 134.153 banorë.

Rajoni i zhvillimit 3 - përfshin qarqet Elbasan, Korçë dhe Berat. Ky rajon ka potenciale të mëdha të zhvillimit të turizmit të brendshëm kulturor, malor dhe liqenor, që stimulojnë turizmin e avenurës dhe atë sportiv (sportet e dëborës dhe të ujit). Territori karakterizohet nga asete historike dhe trashëgimi kulturore, gjithashtu është vendndodhja e “Via Egnatia” Porta e Lindje-Perëndimit. Rajoni ka dalje në Maqedoni dhe Greqi, ç’ka e bën dhe portën hyrëse lindore komëtare.

Qarku Elbasan ka popullsinë më të madhe në rajon dhe renditet i treti në nivel kombëtar pas Tiranës dhe Fierit, me 298.913 banorë e me një dendësi prej 91 banorë për km². I dyti në rajon është qarku i Korçës me 221.706 banorë e me një dendësi prej 63 banorë për km². Qarku i Beratit ka 139.815 banorë dhe një dendësi prej 77 banorë për km².


Rajoni i zhvillimit 4 - përfshin qarqet Fier, Vlorë dhe Gjikastër. Ky rajon ka potenciale të zhvillimit të turizmit bregdetar nga vendndodhja e pasurive të vyera peisazhistike dhe rivierës shqiptare. Gjithashtu, ky territor është mjaft i pasur me asete historike dhe trashëgimi kulturore



të mbrojtura nga UNESCO, si dhe në të shtrihen inteneraret historik të Bektashinjve dhe Alipashës. Rajoni i zhvillimit 4 është porta hyrëse jugore e Shqipërisë me dy pika kufitare me Greqinë dhe dy porte të rëndësishëm në detin Jon.

Qarku i Fierit renditet i dyti në nivel kombëtar me një popullsi prej 312.448 banorësh e me një dendësi 169 banorë për km² në vitin 2016. Nga ana tjetër, në këtë rajon qarku i Gjirokastrës ka dendësinë më të ulët edhe në nivel kombëtar, 24 banorë për km², me një popullsi prej 70.331 banorë. Qarku i Vlorës ka një popullsi prej 183.105 banorësh, me dendësi 69 banorë për km².

Një përmbledhje e shkurtër orientuese e disa potencialeve ose karakteristikave për secilin rajon gjëndet në tabelën si më poshtë:

**Rajoni i Zhvillimit I**

- Potenciale për turizëm malor malor
- Parku kombëtar Lugina e Valbonës
- Itenerari turistik i Alpeve
- Pasuri hidrike
- Infrastruktura lidhëse e ngritur
- Dalje në Malin e Zi dhe Kosovë
- Turizëm ndërkufitar
- Burime natyrore dhe prodhime të veçanta bujqësore

Rajoni i Zhvillimit II

- Shërbimet kryesore publike
- Potenciale për zhvillim ekonomik
- Fasha ekonomike DURANA
- Aeroporti Kombëtar
- Porti detar më i madh në vend
- Itenerari historik i Skënderbeut
- "Rruga e Arbrit"
- Dalje në Maqedoni

Rajoni i Zhvillimit III

- Potenciale të turizmit kulturor / malor / liqenor
- Turizëm sportive dhe i aventurës (*sportet e dëborës dhe ujit*)
- "Via Egnatia" Porta e Lindje -Perëndimit
- Dalje në Maqedoni dhe Greqi
- Asete historike dhe trashëgimi kulturore
- Potencialet bujqësore dhe për agro-turizmin

Rajoni i Zhvillimit IV

- Potenciale të turizmit bregdetar "Riviera Shqiptare"
- Pasuri peisazhiste
- Lugina e Vjosës
- Itenerari historik i Bektashijve
- Itenerari historik i Ali Pashës
- Asete historike dhe trashëgimi
- Kulturore UNESCO sites
- Porti detar
- 2 Pika kufitare me Greqinë
- Potencialet për agro-turizëm dhe akua-kulturë



1.2 Ndërlidhja rajonale dhe ndër-rajonale

Bashkëveprimi, krijimi i partneriteteve rajonale dhe ndër-rajonale mbetet një nga sfidat kryesore të politikës së zhvillimit rajonal dhe kohezionit territorial. Por edhe ndërlidhja rajonale përmes infrastrukturës së zhvillimit midis bashkive të vëndit, por edhe qarqeve të një rajoni etj.

Rëndësi të vecantë ka edhe fuqizimi i lidhjes midis prodhimit dhe konsumit dhe shërbimeve me përfituesit (Aneks 2).

1.3 Infrastruktura për zhvillimin rajonal

Sipas ndarjes së re administrative-territoriale, Shqipëria ka 61 njësi vendore. Rreth 9,451 km është gjatësia e rrugëve rurale rajonale. Shqipëria shtrihet në pjesën perëndimore të gadishullit të Ballkanit. Korridoret më të rëndësishme rrugore janë: rruga Tiranë-Kukës-Prishtinë, Tiranë-Librazhd-Maqedoni, Tiranë-Korçë-Greqi, Tiranë-Fier-Gjirokastrë-Kakavijë, Tiranë-Shkodër-Podgoricë. Po ashtu, vendi ka dalje në detet Adriatik e Jon, nëpërmjet portit të Durrësit, portit të Vlorës, portit të Sarandës, si dhe atij të Shëngjinit.

Ka disa pika kufitare: dy në Shkodër me Malin e Zi (Muriqan dhe Hani i Hotit), me Kosovën (Morinë, Has dhe Tropojë); me Maqedoninë me anë të pikës kufitare të Bllatës dhe të Qafë-Thanës; me Greqinë në pikat Kapshticë, Kakavijë dhe Qafë-Botë.

Nevojitet të konsiderohet zhvillimi i zonave rurale dhe nxitja e zhvillimit të komunikimit ndërrajonal, si sfida për t'u adresuar.

Edhe zhvillimi i rajoneve ndërkufitare përmes ndërlidhjes, por edhe ndërveprimit ekonomik dhe të shërbimeve është një sfidë, por edhe potencial.

1.4 Situata në zonat urbane dhe rurale, si dhe diversiteti ndër-rajonal

Mesatarisht, rreth 48.7% e të gjithë popullsisë banon në zonë urbane, duke reflektuar një tregues mesatar të urbanizimit. Kjo do të thotë se pjesa më e madhe e popullsisë gjendet në zonat rurale, duke i dhënë vendit një fizionomi të zhvillimit të orientuar në aspektin rural. Ndërkohë që nevojitet të adresohet zbutja e varfërisë, zbutja e pabarazive rajonale, promovimi dhe forcimi i ekonomive lokale, krijimi i identiteve lokale dhe rajonale.

2. POTENCIALET

2.1. Zhvillimi i shoqërisë së informacionit dhe teknologjisë

Shkalla e përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, si telefoni celular, internet etj. është rritur vit pas viti. Vrojtime të ndryshme tregojnë se dhe përdorimi i aparateve "smart", tabletave etj. është rritur. Gjithashtu, vërehet një trend në rritje për trafikun e komunikimeve data dhe ulje të trafikut telefonik (zanor). Kjo është një tendencë globale që reflektohet dhe në vendin tonë. Penetrimi i internetit (sipas të dhënave të publikuara nga ITU-ja) për Shqipërinë vlerësohet në afër 60%, penetrimi i *broadband-it* dhe veçanërisht rritja në segmentin *mobile broadband* në nivel 37%, në fund të vitit 2013, bazuar në të gjitha llojet e pajisjeve, përfshirë *smartphone* dhe *tablete*. Pavarësisht nga progresi në fushën e TIK-ut, Shqipëria duhet të rritet drejtë nivelit mesatar, jo vetëm të vendeve të BE-së, por edhe atyre të rajonit lidhur me aksesin në infrastrukturën dhe shërbimet *broadband* dhe kjo është e lidhur me diferencën e madhe të zhvillimit që ekziston midis rajoneve të ndryshme të vendit.



Përdorimi i TIK-ut në disa njësi të qeverisjes qendrore dhe vendore ka gjetur hapësirë në përmirësimin e aksesit të shërbimeve, lehtësimin e qasjes ndaj informacionit, përmirësimin të cilësisë së shërbimeve në një numër fushash të veprimitarisë së pushtetit.

Ky potencial duhet zhvilluar, si në pikëpamje të infrastrukturës ekonomike, por edhe si një mënyrë e uljes së pabarazisë në zhvillim, përmes rritjes dhe përmirësimit të aksesit në shërbime. Konektiviteti dixhital duhet stimuluar, krahas formave tradicionale të ndërlidhjes rajonale.

Prezantimi i Programit “Shqipëria dixhitale” synon të mbështesë më tej, zhvillimin e këtij potenciali, aksesin në shërbime dhe konkurrueshmërinë rajonale.

2.2. Turizmi dhe kultura

Turizmi mund të jetë i tre drejtimeve kryesore: për plazh (det, liqen dhe ballinat ujore, etj.); për mal dhe për atraksione kulturore (kala dhe vepra historike). Asete natyrore, ato kulturore dhe historike, tradita dhe kapitali social etj. duhen vlerësuar si potenciale të zhvillimit rajonal.

2.3. Zhvillimi rajonal mund të arihet përmes rritjes së konkurrueshmërisë së rajoneve

Shqipëria dhe rajonet e zhvillimit kanë potenciale mjaft të vlefshme për zhvillimin e një turizmi që siguron zhvillim ekonomik afatgjatë dhe prosperitet social e mjedisor (shiko hartën në aneksin 1). Vendi ka 450 km bregdet, nga të cilat 300 km në detin Adriatik dhe 150 km në detin Jon. Aty gjenden rreth 24 zona potenciale për zhvillim cilësor turizmi. Ndërkohë, më shumë se gjysma e sipërfaqes së vendit janë zona malore ku ndodhen edhe 15 zona të tjera që kanë gjithashtu potenciale për zhvillimin e turizmit.

Krahas potencialit të zonave turistike detare, Shqipëria ka mjaft potenciale të tjera në brendësi të vendit, përfshi: i) tre liqene (Shkodër, Ohër dhe Prespë), një rrjet liqenesh të vegjël (Dumre, Lurë etj.) dhe dhjetëra liqene artificiale.

Vendi ka 15 parqe kombëtare, zona të ndjeshme ekologjike emeralde dhe zona të tjera pyjore kudo; ii) ekziston një trashëgimi e pasur arkeologjike, përfshirë: Butrintin (UNESCO), Apoloninë, Bylisin dhe Durrësin. Vendi ka dy qytete muze: Beratit dhe Gjirokastrën (UNESCO), dhe mjaft të tjera me cilësi të veçanta arkitektonike apo të traditës (si zonat e kalave, pazareve, etj.); iii) kultura shqiptare ka larminë besimesh fetare, folklori, traditash dhe kostumesh popullore; shumëllojshmëri punimesh artizanale e kulinarie; njerëzit janë miqësorë e mikpritës me të huajt dhe përgjithësisht njohin gjuhët e huaja.

Klima është mesdhetare, me një sezon relativisht të gjatë veror dhe dimër të butë e të lagësht. Asetet natyrore dhe kulturore kanë nevojë (pjesa më e madhe e tyre) për rehabilitim dhe për kthimin e tyre në destinacione të arritshme. Ato shërbejnë si pika të potencialit vendor dhe rajonal, që mund të dinamizojë ekonominë e lidhur, por edhe zhvillimin social dhe kulturor, për diversitetin dhe konkurrueshmërinë rajonale.

Në këtë pikë, F.ZH.R.-ja ka luajtur një rol në konvergjencë me politikat e Ministrisë së Mjedisit, duke financuar projektet për pyllëzim të zonave të caktuara (si për shembull, në Sarandë, Mاکaresh etj.), projekte këto me rëndësi për mbrojtjen dhe rigjenerimin e mjedisit. Mbështetja është dhënë edhe në zonat e potencialit natyror (projektet e ballinave ujore), historik dhe ekonomik, zonat rrotull kalave, pazaret tradicionale etj.



2.4 Bashkëpunimi ndërvendor

Ka shumë raste që mund të konsiderohen si shembull suksesi i bashkëpunimit ndërvendor, pasi janë bërë pjesë e disa projekteve të financuara nga burime të jashtme, ku janë zhvilluar skema të bashkëpunimit rajonal dhe ndërvendor, kryesisht në fushën e mjedisit, bujqësisë dhe turizmit etj.

Përvoja në këto bashkëpunime jep shenja pozitive për synimet e politikës për zhvillimin e rajoneve, për krijimin e partneriteteve dhe rrjetëzimeve rajonale e ndërrajonale. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve mbështet projektet e partneritetit ndërvendor, rajonal, ndërrajonal, si një incentivë për zhvillimin partneriteteve si dhe sinergji për zhvillimin lokal e rajonal. Megjithatë, rajonet e zhvillimit paraqesin disa veçori të poleve zhvillimore dhe potencialeve ekonomike të tyre, mbi të cilat mund të ndërtohen partneritete për zhvillim (shiko harta në aneksin 2).

IV. AKSET PRIORITARE TË PROGRAMIT OPERACIONAL

Programi operacional përfshin 4 objektiva kryesorë zhvillimorë për vitin 2017, që kanë të bëjnë me: i) ndërhyrje në infrastrukturë dhe akses në shërbime; ii) zhvillimin e qëndrueshëm dhe cilësinë e jetës, qytetet moderne; iii) mbështetjen dhe fuqizimin e ekonomive lokale; iv) kohezionin dhe ndërveprimin rajonal, partneritetin vendor, ndërvendor, ndërrajonal. Mund të aplikohen të gjitha apo disa akse prioritare për secilën zonë të zhvillimit rajonal.

Objektivi kryesor 1: Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm

Këtu mund të konsiderohet mbështetja e nismave që shërbejnë si katalizator i zhvillimit territorial në **zonat më pak të zhvilluara**, përmes ndërhyrjeve komplementare të cilat përmirësojnë infrastrukturën vendore dhe rivitalizojnë ekonominë lokale.

Por edhe rritja e vlerës dhe vazhdimësisë së veprimeve dhe ndërhyrjeve transformuese është për t'u konsideruar se kontribuon në modelin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Shtylla I – “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale”

Objektivi specifik 1: Zonat më pak të zhvilluara (Programi i disparitetit)

Këtu mund të konsiderohet zbutja/eliminimi i disparitetit gjeografik dhe të zhvillimit midis rajoneve të zhvillimit dhe njësive vendore.

Formohet nga këto grante:

- a. granti për infrastruktura vendore dhe rajonale;
- b. granti për arsimin bazë;
- c. granti për arsimin e mesëm;
- d. granti për shëndetësinë;
- e. granti për ujësjellës-kanalizimet:
 - Masa 1: Përmirësimi i aksesit, lëvizshmërisë dhe infrastrukturës në zonat më pak të zhvilluara, si dhe në ujësjellës-kanalizime;
 - Masa 2: Përmirësimi i cilësisë së strukturave arsimore, mundësimi i aksesit me zonat e pambuluara me shërbim;
 - Masa 3: Përmirësimi i cilësisë së strukturave shëndetësore, mundësimi i aksesit me zonat e pambuluara me shërbim;



- Masa 4: Shkolla - Qendër komunitare (terrenet sportive);
- Masa 5: Rivitalizimi i zonave informale, sigurimi i infrastrukturës së aksesit.
- Masa 6 : Rritja e aksesit në shërbime, me anë të aksesit në shërbime online, përmes rritjes së mbulimit.

Objektivi specifik 2: Kohezioni territorial dhe zhvillimi i balancuar rajonal (projektet komplementare)

Financimi i projekteve komplementare që lidhin dhe rrisin jetëgjatësinë e investimeve të mëparshme ose të reja, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe konektivitetin.

Formohet nga këto grante:

- a. granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale;
 - b. grantet për arsimin;
 - c. granti për shëndetësinë;
 - d. granti për artin dhe kulturën;
 - e. granti për ujësjellës-kanalizime;
 - f. granti konkurrues për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim;
- Masa 1: Përmirësimi i infrastrukturës për promovimin e atraksioneve, nxitjen e ndërlidhjes rurale-urbane dhe konkurrueshmërisë (infrastrukturë rrugore me interes të veçantë zhvillimi etj.)
 - Masa 2: Përmirësimi i transportit, lëvizshmërisë dhe infrastrukturës ndërlidhëse lokale, ndërvendore, rajonale dhe ndërrajonale.
 - Masa 3: Zhvillimi i zonave funksionale të qyteteve /fshatrave.
 - Masa 4: Shërbime vendore dixhitale për qytetarët dhe biznesin, bazuar në zgjidhjet “Në një sportel”, nëpërmjet platformave të integruara.
 - Masa 5: Pasurimi dhe gjallërimi i parqeve urbane dhe shërbimeve komunitare rural - urban ndërvendore dhe rajonale.
 - Masa 6: Fuqizimi i lidhjeve fshat – qytet, ngritja e qendrave multifunksionale (si edukim-luaj-sport, etj.).

Objektivi kryesor 2: Stimulimi i potencialit ekonomik në zonat me përparësi zhvillimi dhe specifikë zhvillimi

Investime të reja apo mbështetje e projekteve ekzistuese, në grupime **zonash me përparësi zhvillimi dhe specifikë zhvillimi**, me interes turistik, agroturizmi dhe bujqësi dhe me potencial zhvillimi ekonomik (fshatra turistike, itinerarë kulturorë/trashëgimie/historikë etj.), zona të përmisuara të biznesit.

Shtylla I “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale”.

Shtylla III “Programi i mbështetjes për ekonominë”.

Objektivi specifik 1. Stimulimi i zonave dhe poleve potenciale, cluster të zhvillimit dhe zhvillimi i ekonomisë lokale dhe rajonale

Formohet nga këto grante:

- a) granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale;
- b) granti për mbështetjen për ekonominë.
- c) Granti “Shqipëria dixhitale”



- Masa 1: Promovimi i rritjes të rrjetit të tregtisë, ngritjes dhe zhvillimit të zonave të përmirësuara të biznesit, si edhe stimulimi i investimeve në grupime zonash me interes agroturizëm, etj;
- Masa 2: Promovimi dhe fuqizimi i zonave me potencial ekonomik (investime për krijimin e vlerës së shtuar;
- Masa 3: Plotësimi dhe përmirësimi i infrastrukturave lidhëse në ndihmë të zhvillimit të zonave ekonomike lokale dhe rajonale me qëllim përmirësimin e rrjeteve të shpërndarjes së produkteve;
- Masa 4: Promovimi i ngritjes së itinerareve kulturore/turistike grupime zonash me interes turistik, bujqësor, fshatra apo të kapitalit lokal dhe rajonal etj;
- Masa 5: Për t'u zhvilluar sipas pikës 2.3, të aneksit 3, të ligjit të buxhetit për vitin 2017.;

Objektivi specifik 2. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm, si shtysë për konkurrueshmërinë dhe zhvillim rajonal

Formohet nga këto grante:

- a) granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale;
- b) granti për mbështetjen për ekonominë.
- Masa 1: Plotësimi dhe përmirësimi i infrastrukturave lidhëse dhe të aksesit në ndihmë të zhvillimit të zonave turistike.
- Masa 2: Rivitalizimi i qendrave të fshatrave turistike me qëllim fuqizimin e ekonomisë lokale.
- Masa 3: Ndërtimi i infrastrukturave të turizmit me qëllim shfrytëzimin e burimeve natyrore për zhvillimin e turizmit.

Objektivi specifik 3. Mbështetje për ekonominë rajonale

Formohet nga këto grante,

- a) granti: “Nënprogrami specifik i pjesëmarrjes shtetërore me instrumente të financimit dhe forma partneriteti në shoqëri tregtare” dhe granti: “Nënprogrami specifik i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të)”;
- Masa 1: Mbështetje financiare për zhvillim ekonomik dhe nënObjektivi specifikn e zhvillimit rajonal e lokal përmes mbështetjes së NVM-ve (ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme);
- Masa 2: Mbështetje financiare për projekte të njësive ekonomike të njësive të pushtetit vendor.

Objektivi kryesor 3: Qytetet moderne

Këtu mund të konsiderohet përmirësimi dhe modernizimi i shërbimeve publike përmes platformave inovative në shërbim të qytetarëve dhe biznesit; Ndërtimi i sistemeve dixhitale multifunksionale për menaxhimin e infrastrukturës së qyteteve, planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe shërbimeve vendore dixhitale për qytetarët e biznesit, si dhe sistemeve të informacionit për qytetarët, rritja e mbulimit duke rritur kështu aksesin në shërbime.

Shtylla II – Programi “Shqipëria dixhitale”

**Objektivi specifik 1. Fuqizimi i ndërhyrjeve të nisura dhe rivitalizimi i qytetit, fshatit, poliqendrave urbane.**

Formohet nga këto grante:

- b) granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale;
- c) granti për ujësjellës-kanalizime;
- d) granti konkurrues për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim;

Masa 1: Rivitalizimi i hapësirave publike, hapësirave me tipare natyrore, zonave dhe infrastrukturës në shërbim të ekonomive lokale dhe rajonale.

Masa 2: Rivitalizimi i poliqendrave urbane dhe qendrave lokale, rrjetëzimi dhe nxitja përmes bashkjetesës komunitare.

Masa 3: Përmirësimi i aksesit, lëvizshmërisë dhe infrastrukturës së ndërlidhjes.

Masa 4: Rehabilitimi mjedisor, gjelbërimi e gjallërimi i parqeve urbane, ndërvendore, etj.

Masa 5: Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve përmes zhvillimit të potencialeve.

Objektivi specifik 2. Modernizimi i sistemeve, menaxhimit dhe shërbimeve për qytetarët dhe konkurrueshmërisë ekonomike.

Formohet nga granti “Shqipëria dixhitale”

- Masa 1: Platforma inovative me të dhënat e qyteteve në shërbim të qytetarëve;
- Masa 2: Sisteme dixhitale multifunksionale për menaxhimin e infrastrukturës së qyteteve në shërbim të qytetarëve dhe sistemet për përmirësimin e administrimit vendor dhe rajonal (bashkitë etj.)
- Masa 3: Sisteme gjeografike dhe të informacionit për programimin dhe zhvillimin e territorit dhe menaxhimin në nivel rajonal.

Këto objektiva detajohen më pas në drejtime prioritare, përmes granteve dhe në masa për arritjen e tyre.

V. FINANCIMI

Për vitin buxhetor 2017, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është planifikuar në tre shtylla kryesore financimi, specifikuar, si më poshtë vijnë:

A. Shtylla I: “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale”

Ky program përbëhet nga 6 grante konkurruese, specifikuar, si më poshtë vijon:

7. Granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale ka burim financimi Programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale” pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban;
8. Grantet për arsimin kanë burim financimi programet e mëposhtme buxhetore të Ministrisë së Arsimit:
 - i. granti për arsimin bazë, me burim financimi Programin e buxhetit “Arsimi bazë (përfshirë arsimin parashkollor)”;
 - ii. granti për arsimin e mesëm, me burim financimi Programin e buxhetit “Arsimi i mesëm (I përgjithshëm)”;
 - iii. granti për arsimin universitar, me burim financimi Programin e buxhetit “Arsimi universitar”;
 - iv. granti për sportin, me burim financimi Programin e buxhetit “Mbështetje për sportin”;
9. Granti për shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor) ka burim financimi Programin e buxhetit “Shërbimet e kujdesit parësor”, të Ministrisë së Shëndetësisë;
10. Granti për artin dhe kulturën ka burim financimi Programin e buxhetit “Arti dhe kultura”, të Ministrisë së Kulturës;



11. Granti për ujësjellës-kanalizime ka burim financimi Programin e buxhetit “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe grantin konkurrues për infrastrukturën vendore dhe rajonale;
12. Granti konkurrues për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzimin ka burim financimi Programin e buxhetit “Administrimi i pyjeve”, të Ministrisë së Mjedisit.

B. Shtylla II: Programi “Shqipëria dixhitale”

Ky porogram që përfshin inovacionin dhe teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, ka burim financimi Programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale” pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban.

Ky program përbëhet nga një grant konkurrues, si më poshtë vijon:

- a) Granti konkurrues për “Shqipëria dixhitale”.

C. Shtylla III: “Programi i mbështetjes për ekonominë”

Programi i shtyllës 3: “Mbështetje për ekonominë” ka burim financimi Programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale” pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe përbëhet nga grantet:

- a) Granti: “Nën Programi i pjesëmarrjes shtetërore me instrumente të financimit dhe forma partneriteti në shoqëri tregtare”;

dhe

- b) Granti: “Nën Programi i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të)”.

VI. PERFORMANCA DHE MONITORIMI


Monitorimi i programeve bëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në aneksin 3, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe aktet ligjore dhe nënligjore të zbatueshme në fuqi.

Sipas legjislacionit në fuqi, përgjegjës për këtë janë ministritë dhe sekretariatet përkatëse, si edhe autoritetet zbatuese të projekteve.




Aneksi 1

RAJONET E ZHVILLIMIT - POLET E ZHVILLIMIT RAJONAL




Aneksi 2.1 Tipologjitë rajonale dhe territoriale





Aneksi 2.2 Vështrim mbi potencialet



**VENDIM****Nr. 14, datë 21.3.2017**

**PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT PËR
GRANTIN “NËNPROGRAMI I
MBËSHTETJES FINANCIARE PËR
NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA
DHE TË MESME (NMVM)”, TË
PROGRAMIT “MBËSHTETJE PËR
EKONOMINË”, SI DHE TË
KALENDARIT ME DATËN E FILLIMIT
TË APLIKIMEVE, PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të vendimit nr.961, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të agjencive të zhvillimit rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”, si dhe të pikës 7, të vendimit nr.580, datë 3.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e programit për mbështetjen e ekonomisë dhe përcaktimin e përfituesve e të rregullave për zbatimin e tij”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit për grantin “Nënprogrami i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)”, bashkëlidhur programit “Mbështetje për ekonominë”, në vlerën, për vitin 2017, prej 400

000 000 (katërqind milionë) lekësh, të cilën do ta administrojë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal.

2. Miratimin e datës së fillimit të aplikimeve për nënprogramin, sipas pikës 1, të këtij vendimi, e cila të jetë sipas kalendarit, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen ministri i Financave, ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Edi Rama**

Zëvendëskryeministri
Ministri i Financave
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Ministri i Zhvillimit Urban
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës
Ministri i Arsimit dhe Sportit
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
Administrimit të Ujërave
Ministri i Shëndetësisë
Ministri i Kulturës
Ministri i Mjedisit
Ministri i Punëve të Brendshme
Ministri i Shtetit për Inovacionin
dhe Administratën Publike
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4

Zëvendëskryetar;
anëtar;

anëtar
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;

ANEKSI I: KALENDARI ME DATËN E FILLIMIT TË APLIKIMIT

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në “Fletoren Zyrtare”	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Datën e fillimit të aplikimeve për “Nënprogrami i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të)”.
Thirrja I, 2017 (brenda javës së tretë të muajit prill)	Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal (AZHER)	Dërgimi e aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: - Aplikimi me email në info@red.gov.al ose me postë, ku dosja e plotë e aplikimit (bashkë me materialet në CD), dërgohet pranë sekretariatit teknik përkatës, në zyrat e AZHER.
Thirrja II, 2017 (brenda javës së tretë të muajit maj)		Agjencia pranon aplikimet sipas formatit të botuar në faqen zyrtare të agjencisë www.red.gov.al dhe krijon bazën e të dhënave për projekt-aplikimet.



FONDI PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE
PROGRAMI I MBËSHTETJES PËR EKONOMINË
NËNPROGRAMI I MBËSHTETJES FINANCIARE
PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME

* Miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore Nr. 70 datë 6.12.2016,
në zbatim të Aneksit 3/2, të ligjit nr. 147/2016, "Për buxhetin e vitit 2016" dhe Vendimit të Këshillit të
Ministres Nr. 580 datë 03.08.2016, "Për krijimin e Programit për Mbështetjen e Ekonomisë dhe përcaktimin
e përfituesve e rregullave për zbatimin e tij"

HYRJA E PROGRAMIT "MBËSHTETJA PËR EKONOMINË"

a) Qëllimi i Programit "Mbështetja për Ekonominë"

Programi "Mbështetja për Ekonominë" ka për qëllim kryesisht të nxisë zhvillimin e ekonomive lokale dhe rajonale, si dhe punësimin, me një qasje territoriale, duke zhvilluar zona të të bërit biznes si pole për zhvillimin lokal dhe rajonal, përmes krijimit dhe transformimit të zonave të përmirësuara të biznesit, si masë shoqëruese në zona ku kryhen investime infrastrukturore nga Programi i Mbështetjes së Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, granti "Infrastruktura vendore dhe rajonale", duke rritur potencialin e tyre të konkurrueshmërisë rajonale, dhe aktivizimin e kapitaleve të "fjetura".

Objekti kryesor i Programit përcaktohet sipas pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 580 datë 03.08.2016.

b) Nën-Programet dhe Skemat e Programit

Programi Mbështetja për Ekonominë Rajonale, ndahet në dy nënprograme si vijon:

(i) Nën-programi: financimi i pjesëmarrjes në shoqëri tregtare dhe instrumente të financimit për bizneset start-up, i cili u mundëson njësive të qeverisjes vendore, që në bashkë-financim me Agjencinë për Zhvillim Ekonomik Rajonal, të krijojnë aktivitete ekonomike dhe tregtare të tyre dhe ose të përbashkëta, me qëllim zhvillimin e potencialeve ekonomike të zonës së tyre.

(ii) Nënprogrami: "Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme (NMVM)", Ky nënprogram, i cili financon me grant direkt njësitet tregtare private dhe/ ose njësi ekonomike të njësive të qeverisjes vendore ka për qëllim rigjallërimin e aktiviteteve të njësive të qeverisjes vendore, ekonomike dhe krijimin e poleve të zhvillimit ekonomik, lokal dhe rajonal, në funksion të krijimit të vendeve të reja të punës, si dhe të rritjes së të ardhurave shtesë për njësitet e qeverisjes vendore. Këto të ardhura do të mund të ripërdoren për programe të zhvillimit ekonomik në zonën e këtyre njësive të qeverisjes vendore. Fokusi i veçantë territorial i tij janë zona të cilat paraqesin potencial për t'u transformuar në "Zona të përmirësuara biznesi", ku përmes mbështetjes së biznesit në to (masa të buta), jo vetëm rritet ekonomia lokale, por mund të krijohet një rrjet i zonave të biznesit përgjatë rajoneve të vendit, por edhe rritet vlera dhe impakti i ndërhyrjeve infrastrukturore (masa të forta), të kryera ose që kryhen në qytetet dhe fshatrat tona, përmes Programit "Infrastruktura vendore dhe rajonale". Të tilla zona, me potencial për "Zona të përmirësuara të biznesit" mund të jenë vendodhje si pazaret, markatat dhe tregjet, rrugët tregtare, pedonale, zonat rrotull atraksioneve si dhe ballinat ujore, kalatë etj.

Shënim: Në këtë propozim, paraqiten vetëm detajet e Nënprogramit të dytë "Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)".



A. NËNPROGRAMI: MBËSHTETJA FINANCIARE PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME (MNVM)

1. Deklarata e Politikës së Nënprogramit

1.1. Qëllimi i Politikës

Qëllimi kryesor i politikës së nënprogramit është të krijojë njësi të reja e të mirë-organizuara ekonomike (Economic Clusters) të profilizuara sipas vendndodhjes apo llojit të shërbimit, me mbështetjen aktive të njësisë të qeverisjes vendore, duke fuqizuar zonat me potencial “zona të përmirësuara biznesi”, si pole lidhese ose rajonale zhvillimi, të cilat do të mund të përdorin, por dhe të zhvillojnë edhe më tej investimet private dhe ato publike, në projektet infrastrukturore të financuara përmes programeve të tjera (programi i infrastruktures vendore dhe rajonale) të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

Rrjedhimisht përmes këtij modeli, banorët përreth zonave të investimeve do të kenë më tepër potenciale punësimi, do të përfitojnë nga rritja e vlerës së pronës, nga aktivitetet e shtuara ekonomike të zonës si dhe nga shtimi i investimeve të reja, private apo publike. Kjo, në terma reale mund të krijojë një mekanizëm të ri aktiv të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, e më tepër prosperitet ekonomik për gjithë zonën dhe banorët përreth saj, në modelin e një organizimi territorial të tipit zonë biznesi, i cili nxit vlerat e shtuara dhe kombinimin e energjive publike me ato private.

1.2. Përshkrimi i nënprogramit

Në kuadër të këtij nënprogrami, Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal analizon, koordinon, mbështet, monitoron dhe ndërlidh, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe agjenci të tjera të zhvillimit rajonal, proceset respektive për krijimin e poleve të reja të zhvillimit ekonomik (ose *zonave të përmirësuara të zhvillimit ekonomik*) më gjerë dhe në një kategori të tyre “zonat e përmirësuara të biznesit”, lokal dhe rajonal, me fokus zhvillimin e potencialeve ekonomike, lokale dhe rajonale, të territoreve në të cilat janë kryer ose do të kryhen ndërhyrje infrastrukturore nga Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës dhe të rritjes së mirëqënies ekonomike të banorëve, shtimi e vlerës dhe shtimin e impaktit.

Përmes këtij nënprogrami, së pari, hartëzohen dhe analizohen potencialet ekonomike të territoreve të lidhura me investimet infrastrukturore, sipas drejtimeve specifike në vazhdim. Në fokus janë aftësia sipërmarrëse, trendi për sipërmarrje të reja dhe konvertimi i rrjeteve të tregtisë në zinxhirin rajonal të vlerës etj. Në partneritet edhe me njësitë e qeverisjes vendore dhe partnerëve të tjerë vendas ose të huaj që mund të operojnë në ato zona, hartohet dhe dakortësohet një plan i përbashkët zhvillimi ekonomik të vendndodhjes, për të gjithë zonimin në të cilën do të kryhet ndërhyrja, përmes mbështetjes së biznesit ose segmenteve të caktuara të tij që promovohen në atë zonë. Ky plan detajon masat financiare, përfshirë llojet dhe detajet e ndërhyrjeve, për çdo njësi ekonomike që do të mbështetet me grant nga ky nënprogram, nga ku Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal, përmes Njesisë së Monitorimit të Projekteve, do të monitorojë indikatorët specifikë të efektit të pritshëm. Në vijim, Agjencia do të vijojë bashkëpunimin me institucione të pushtetit qendror, vendor dhe partnerëve për zhvillim për të ndërlidhur aktivitetet e asaj zone të përmirësuar biznesi, me njësi të tjera ekonomike të një shkalle më të gjerë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, me modelin e zgjerimit nga kjo bërthamë ndërhyrje në më gjerë. Objektivi është që përmes mbështetjes së një zone të përmirësuar biznesi, të mund të avancohet më gjërë në krijimin e një zone të përmirësuar ekonomike, përmes zhvillimit të zinxhirit të vlerës, me impakt lokal dhe rajonal.

Në disa raste, vetë njësitë e qeverisjes vendore do të duan drejtpërdrejt të ndërmarrin iniciativën për krijimin e këtyre poleve të zhvillimit ekonomik, duke përdorur dhe shfrytëzuar edhe asete të tjera publike që mund t'i kenë në dispozicion, por që mund të mos jenë shfrytëzuar deri në atë moment për mungesë të nismës zhvillimore të biznesit, ndërlidhjes ose instrumentave asistues financiarë.

Indikatorët specifikë do të jenë të lidhur me vendet e reja të punës direkte, vlerës së shtuar të investimit, të krijuar përmes ndërhyrjes si dhe krijimi i të ardhurave shtesë për vetë njësitë e qeverisjes vendore, nga ku këto të ardhura do të duhet të përdoren si burim financimi për aktivitete të tjera ekonomiko-



zhvillimore nga vetë njësitë e qeverisjes vendore, në zonat ku ato operojnë, diversifikim apo konvertim aktiviteti, impakt në aktivitete të lidhura, promovimi i tipareve ekonomike të zonës etj.

Përmes Nënprogramit “Mbështetja Financiare për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme”, Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal, synon të ndikojë në fuqizimin si fazë e parë pilot në 2017-2018, në:

- 4-8 zona të përmirësuara biznesi, të shpërndara në rajone të ndryshme të Shqipërisë,

përmes të cilave do të mbështesë:

- 80-100 projekte të sipërmarrjeve private brenda zonave të përmirësuara të biznesit, të përcaktuara nga planet e ndërhyrjes në zonë, nga të cilat do të mund të gjenerohen rreth 50-100 vende pune direkte, si dhe synon që kjo mbështetje të aktivizojnë një vlerë investimesh prej 200-300 milion lekë nga sektori privat.
- 3-4 projekte të njësive ekonomike (NMVM) të njësive të pushtetit vendor, të cilat synohet se mund të gjenerojnë deri në 500-1.000 vende pune të reja, si dhe nxisë aktivizimin e një vlere investimesh shtesë prej rreth 200-300 milion lekë.

1.3. Objektivat e Nënprogramit

Objektivat kryesore dhe strategjikë të nënprogramit janë:

- a) Krijimi i njësive të reja ekonomike në rajonet, zonat me potencial për t'u zhvilluar si “zona të përmirësuara biznesi” ose “zona të përmirësuara ekonomike” ku ka pasur ndërhyrje infrastrukturore nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për rritjen e punësimit të banorëve të atij rajoni, si dhe shtimin e zinxhirit të vlerës, duke mbështetur krijimin e aktiviteteve të tjera ekonomike shoqëruese.
- b) Krijimi i strukturave të përshtatshme për menaxhimin e formave të investimit të qëndrueshëm ekonomik në sipërmarrje të madhësive të ndryshme, duke iu përshtatur potenciale territoriale dhe të kapaciteteve të zonës, si dhe nevojave ekonomike të zonës. Kjo do ndikojë në angazhimet e likuiditeve të “fjetura” të kapitalit privat si dhe do të mund të orientojë investime të reja nga partnerët, për zhvillimin, njësitë vendore etj.
- c) Rritja e punësimit direkt dhe indirekt krahasuar me nivelet ekzistuese, si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore të zonave dhe rajoneve në fokus si rezultat i mbështetjes teknike nga programe të tjera të ngjashme, si dhe nga investime të përbashkëta në sipërmarrjet e krijuara.
- d) Ndikimi në krijimin e bizneseve të reja shoqëruese, si dhe fuqizimi, rritja e xhiros, rritja e të ardhurave shtesë si dhe diversifikimi i bizneseve, me ndikim në përmirësimin dhe zhvillimin e zonës përkatëse ku kryhet investimi, dhe rritjes së konkurrueshmërisë rajonale.
- e) Ndikimi në vlerën e shtuar, tërheqjen e investimeve, përmes bashkëfinancimit, gjenerimit të projekteve të reja, përmirësimit të shërbimeve, etj.

1.4. Drejtimit e Nënprogramit

Drejtimit e nënprogramit janë për skema granti që:

- a) nxisin zhvillimin ekonomik lokal e rajonal dhe punësimin, përmes krijimit dhe transformimit të zonave të përmirësuara të biznesit¹, si masë shoqëruese në zona ku kryhen investime infrastrukturore nga Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, duke rritur potencialin e tyre të konkurrueshmërisë rajonale, dhe aktivizimin e kapitaleve, si:
 - i. pazaret, tregjet, markatat, njësitë territoriale dhe ekonomike të ngjashme;
 - ii. rrugët tregtare, bulevardet, pedonalet, sheshet;

¹ Zonat specifike të ndërhyrjes sipas drejtimeve të Nënprogramit detajohen në Aneksin 1.



- iii. zonat rrotull atraksioneve historike, të trashëgimisë kulturore, kalave etj; objekteve me rëndësi kombëtare;
 - iv. zonat e rehabilituara pranë ballinave ujore dhe natyrore, me potencial turistik dhe shërbimesh;
- b) mbështetjen e projekteve të njësive ekonomike të njësive të qeverisjes vendore, për rigjallërimin e aktivitetit ekonomik dhe poleve të zhvillimit lokal/rajonat, në funksion të krijimit të punësimit dhe të ardhurave shtesë, të cilat do të ripërdoren për zhvillimin ekonomik të zonës.

1.5. Skemat e Financimit dhe kriteret e përzgjedhjes së zonave ku do të ndërhyjë programi, për mbështetjen e NMVM-ve

Ky nënprogram ofron mbështetje financiare NMVM-të, në formën e bashkëfinancimit për investimet nga njësi biznesi në zonat me potencial "zona të përmirësuar të biznesit". Aplikantët do të mund të përfitojnë, grante deri në 50% të vlerës totale të investimit. Gjithashtu Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal, paralelisht, do të ofrojë asistencë teknike për zhvillimin e projekteve të territorit përkatës direkt, ose duke koordinuar programe të tjera nga partnerët për zhvillimin apo institucione të tjera publike.

Nënprogrami	Skemat	Format e financimit	Lloji i financimit
II. Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)	1. Mbështetje për NMVM për krijimin e zonave të përmirësuar të biznesit	Grant për investime Grant për asistencë teknike për zhvillim dhe menaxhim	▪ 50% e vlerës totale të investimit ▪ Deri në 2,5 milion lekë/projekt
	2. Mbështetje për projekte të njësive ekonomike të njësive të qeverisjes vendore	Grant për investime Grant asistencë teknike për zhvillim dhe menaxhim	▪ 50% e vlerës totale të investimit ▪ Deri në 30 milion lekë/projekt

Kriteret përcaktohen me vendim të veçantë, por janë për zonat e përmirësuar të biznesit, me potencial zhvillimi, sipas Aneksit 1 bashkëlidhur.

1.6. Propozimi për Financim

Nënprogrami "Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)" për të dyja skemat:

- 1) Mbështetje për NMVM për krijimin e zonave të përmirësuar të biznesit
- 2) Mbështetje për projekte të njësive ekonomike të njësive të qeverisjes vendore,

dhe propozohet të ekzekutohet brenda periudhës 2017 – 2018.

Për vitin 2017, nënprogrami do të ketë të paktën 2 thirrje.

Zonat specifike të ndërhyrjes përmes kësaj skeme detajohen në aneksin 1.

Për skemën e dytë nuk ka kufizim të zonave të ndërhyrjes, por gjithësesi përfituesit duhet të plotësojnë kriteret sipas pikës 1.8 të këtij dokumenti dhe akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Kushtet, kriteret, masat, llojet e përfitimeve si dhe procedurat për aplikim, përzgjedhje, monitorim dhe raportim, të këtyre thirrjeve, përcaktohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 580 datë 03.08.2016 "Për krijimin e programit për mbështetjen e ekonomisë dhe përcaktimin e përfituesve dhe të rregullave për zbatimin e tij" dhe sipas legjislacionit të aplikueshëm në fuqi.



1.7. Burimet e Financimit

Nënprogrami “Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)” mund të financohet potencialisht nga burimet financiare në vijim:

- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, programi “Mbështetja për ekonominë”;
- Kontribute nga buxheti i shtetit, dhe buxheti vendor sipas marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit;
- Fondet nga instrumentat e financimit të Bashkimit Europian;
- Subjekte juridike, publike dhe /ose private, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve përkatëse;
- Fonde të përfituara nga marrëveshjet me partnerët për zhvillim të ndryshëm, për financimin e projekteve, të zbatuara prej tyre;

1.8. Subjektet përfituese dhe kriteret e aplikimit

Për sa i përket përfituesve të nënprogramit, ata detajohen sipas VKM 580 datë 03.08.2016, si dhe sipas tabelës si më poshtë:

Nënprogrami	Skemat	Përfituesit
II. Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)	1. Mbështetje për NMVM për krijimin e zonave të përmirësuara të biznesit	Sipërmarrje private mikro, të vogla dhe të mesme, që kryejnë aktivitetin brenda zonës së përmirësuar të biznesit, siç definohet nga plani i ndërhyrjes në zonë i përgatitur nga Agjencia në partneritet me njësitë e qeverisjes vendore
	2. Mbështetje për projekte të njësive ekonomike të njësive të qeverisjes vendore	NMVM-të (shoqëritë tregtare) të njësive të qeverisjes vendore, të cilat kanë projekte konkrete, me një plan biznesi të qartë, dhe që do të ofrojnë paralelisht bashkëfinancim, me synim rigjallërimin e aktivitetit ekonomik, rritjen e të ardhurave në buxhetin e njësisë ekonomike, për t'i ripërdorur këto të ardhura për programe të tjera të ngjashme për zhvillimin ekonomik të zonës së tyre etj.

Në çdo rast, sipërmarrjet private përfituese nga ky nënprogram, për të aplikuar duhet të plotësojnë kushtet, sipas pikës 4.5 dhe 4.6 të VKM 580 datë 03.08.2016.

Subjektet duhet të plotësojnë kushtin që të kenë projektin e njësisë së biznesit për të cilin kërkohet mbështetja me grant, të zbatueshëm brenda zonës së përmirësuar të biznesit të përzgjedhur.

1.9. Monitorimi

Monitorimi i projekteve tek përfituesit e grantit, mund të bëhet në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, sipas një marrëveshje mirëkuptimi midis palëve, ose edhe nga vetë Agjencia për zhvillim ekonomik rajonal.

Ndërsa rregullat për monitorimin e nënprogramit, rregullohen me vendim të veçantë.



1.10. Indikatorët e Matjes së Performancës së Nënprogramit

Numri i Zonave të përmirësuara të biznesit,	Përmes këtij nënprogrami synohet të ndërhyhet për të rritur potencialin në 4-8 zona të përmirësuara biznesi, të cilat konsiderohen “cluster zhvillimorë” brenda një territori të caktuar, për të cilin është hartuar një plan ndërhyrjeje dhe për të cilat janë koordinuar aktorët (vendorë dhe qëndrorë), me mbështetje për NMVM-të.
Numri i zonave të ndërhyrjes	
Numri i Projekteve të mbështetur	Mbështetja e sipërmarrjeve ka si indikator kryesor financimin e rreth 80-100 projekteve të sipërmarrjeve private si dhe financimin e rreth 3-4 projekteve të njësisë ekonomike të njësisë të pushtetit vendor.
Vlera totale e kapitaleve të aktivizuara në investim (Lekë)	Përmes menaxhimit efektiv të rreth 400 milion lekëve financim publik për 2017 si grante mbështetjeje për NVMN-të përmes agjensisë, synohet që ato të mund të aktivizojnë rreth 400-600 milion lekë investime (bruto) totale në njësi biznesi (vendndodhje), me potencialin e një koeficienti shumëfishimi edhe më të madh, konsideruar kontributet e tjera nga aktorët e tjerë (private, donatorë, banka zhvillimi, etj) Në rast se përveç vlerës së bashkëfinancimit, konsiderohet edhe shtimi i vlerës së pronës, shtimi i produktivitetit dhe qarkullimit financiar të zonës, vlera e punësimit si dhe vlera e shtuar e shërbimeve mbështetëse të zonës, do të mund të arrihet një koeficient 1:4.5, ku për çdo 1 lek të investuar përmes këtij nënprogrami, do të gjenerohen direkt dhe indirekt 4.5 lekë total investimesh.
Vende të reja pune (%)	Objekti është në rritjen e punësimit me 40% të niveleve ekzistuese të të punësuarve të njësisë apo të zonës dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në zonat e përmirësuara të biznesit, ku kryhet edhe investimi. Paralelisht, projektet do rrisin aftësitë profesionale të burimeve njerëzore të zonës në të cilën kryhen investimet, me anë të mbështetjes dhe incentivave të tjera të koordinuara nga Agjencia, përmes partnerëve për rritje të cilësisë dhe aftësisë profesionale për më tepër eficiencë dhe produktivitet.
Hapja e sipërmarrjeve të reja (Nr.)	Hapja e 20-30 sipërmarrjeve të reja si pasojë e zhvillimit të investimeve në disa zona të caktuara, nga të cilat do të mund të ngrihen biznese të tjera, si shoqërim i shërbimeve ekonomike të sipërmarrjeve që janë mbështetur nga nënprogrami.
Rritja e xhiros vjetore të sipërmarrjeve (%)	Rritja me 15-30% e xhiros vjetore e bizneseve ku bëhet implementimi i mbështetjes me grant për investime apo menaxhim, si dhe rritje e produktivitetit të veprimtarive ekonomike përmes përmirësimit të shërbimeve, të cilësisë dhe operacioneve, do të mund të stimulojë rritjen e vlerës së shtuar të të gjithë zonës dhe sipërmarrjeve përbërëse të saj.

**ANEKSI 1**

LISTA E TIPEVE TË NDËRHYRJEVE INFRASTRUKTURE TË FZHR 2014-2016
ME POTENCIAL ZHVILLIMI NE ZONA TE PERMIRESUARA BIZNESI *

Pedonale	Shetitore/ Bulevarde	Sheshe	Pazare	Ballina Ujore	Tregje	Mjedise Historike (Kala)
Tirane	Elbasan	Kukes	Kruje	Pogradec	Lushnje	Tirane
Korce	Fier	Rreshen	Tirane	Berat	Gjirokaster	Gjirokaster
Berat	Lushnje	Lezhe	Fier	Vlore	Tirane	Berat
Bulqize	Durres	Durres	Korce	Qeparo, Himare	Korce	Kruje
Kavaje	Shijak	Tirane	Gjirokaster	Himare	Fier	Elbasan
Lushnje	Velipoje, Shkoder	Elbasan		Leshniqe, Kavaje		Tepelene
Fier	Bajram Curri	Lushnje		Belsh		
Tamare, Malesi e Madhe	Diber	Berat				
Razem, Malesi e Madhe	Berat	Voskopoje				
Shkoder	Korce	Borsh, Himare				
	Sarande	Kudhes, Himare				
	Himare	Pilur, Himare				
		Permet				

* zona rrotull dhe brenda

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë